



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351-163979
Dt. 23.09.2016

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e Arnes Vejapi nga Prizreni me banim në rrugën “Muhamet Çami” në bazë të neneve 3-1.7. , 1.17. dhe nenit 5.1.1 si dhe nenit 14.1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 17 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 82,83,84,85 e në lidhje me nenin 86. LPA-së nr. 02/L-28, merr këtë:

AKTVENDIM

I. **I LEJOHËT: Arnes Vejapi** që të ndërtoj objektin e rinj - Shtëpi individuale në Prizren në vendin e ashtuquajtur “Dardania ish Jaglenica “ rrugën “Muhamet Çami” nr. 265/2 në ngastrën kadastrale e cila është e identifikuar në Aktin mbi kushtet për rregullimin e hapësirës nr. 04-353-117977 si dhe me Aktvendimin mbi lokacionin e objektit, sipas dokumentacionit teknik e cila është e hartuar nga ana e byrosë projektuese “Standard Projekt”.

II. Dokumentacioni Teknik e mbanë titullin e tipit veçantë.

III. Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej 94.459,90 €.

IV. Ndërtimi i objekteve ndihmëse s’është e lejuar si dhe vlera e këtyre objekteve, është përjashtuar nga paralogaria e vlerës së objektit.

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë me shkrim organin kompetent (inspektionin e ndërtimtarisë) në afat prej 8ditësh.

VI. Pas përfundimit të ndërtimit të objektit investitori duhet të parashtrojë kërkesë për marrjen e lejes për përdorim.

VII. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se investitori me punë nuk fillon brenda afatit prej 12 (dymbëdhjet) muajsh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së ndërtimit.

VIII. Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve urbanistike si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori, të njëjtit të vërtetuar në aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës

IX. Pronarët e pronave fqinje kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit (shikimin e dokumentacionit).

X. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit ,kanalizimit, PTK,KEDS-it, dhe avari tjera ti evitoj dhe ti kthej në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.

.../...

Arsyetim

Parashtruesi i kërkesës: Arnes Vejapi nga **Prizreni** me banim në rrugën **“Muhamet Cami” nr. 265/2** i është drejtuar këtij organi për marrjen e lejes së ndërtimit për ndërtim të **objektit - Shtëpi individuale**.

Duke shfletuar dokumentacionin teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara këtij organi s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Që me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Që parashtruesi i kërkesës ka miratuar të gjitha pagesat rreth ndërtimit të objektit si dhe s’bashku me kërkesë në shtojcë ka parashtruar këto dokumente të duhura: kopjen e planit, listën poseduese, aktvendimin mbi bartjen e pronësisë, me të cilat i ka zgjidhur marrëdhëniet pronësoro – juridike, Aktin mbi kushtet e rregullimit të hapësirës, aktvendimin mbi lokacionin, dëftesë pagesat që i ka paguar kontributet për rregullimin e tokës ndërtimore, si dhe projektet.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit mbi ndërtimin e të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes së ndërtimit.

Nga se u tha më lartë u muarr aktvendimi si në dispozitiv.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE; Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, përmes këtij organi.


Ankesa taksohet me 0.50 Euro taksa administrative.

Bashk.profesional:



Xhejlane Gjini, inxh.dipl.ark

DREJTORI:




Isar Islamaj